

Virgjil Muçi

Vështrim mbi faqet kulturore në shtypin e përditshëm shqiptar

(Monitorim i pesë gazetave të përditshme gjatë muajit shtator 2007)

1.

Ky vështrim nuk synon të jetë një studim shterrues rreth problematikave të shtypit shqiptar dhe, veçmasi, atyre që kanë të bëjnë me shtypin kulturor. Është kuptimplotë fakti që vëzhgimi ynë rrok një periudhë të caktuar kohore, një muaj, atë të shtatorit të këtij viti dhe, nga ana tjetër, në morinë e të përditshmeve shqiptare shkon e fokusohet vetëm në pesë gazeta: Nga Gazeta Shqiptare ndër më të hershmet në treg pas viteve nëntëdhjetë, Shekulli, Standard, Panorama dhe mbyllet me më të vonën, Shqip. Përzgjedhja e periudhës kohore ka pasur parasysh një muaj që mendohet se ka një veprimtari të ngjeshur e të larmishme në lëmë të kulturës dhe arteve, ndërsa gazetat e sipërpërmendura janë përzgjedhur për shkak të profilit tashmë të konsoliduar në median e shkruar shqiptare. Disa nga parametrat e studimit që janë pasur parasysh janë si më poshtë: hapësira që i kushtohet kulturës, shpeshësia dhe mënyra se si shkruhen artikujt kritik për librin, por edhe për fusha të tjera të krijimtarisë artistike, si filmi, ekspozitat e artit pamor, teatri etj., vëmendja që u kushtohet burimeve, sa vend zënë intervistat me shkrimtarë e artistë dhe mënyra e formulimit të pyetjeve, përzgjedhja që u bëhet ngjarjeve artistike e kulturore për t'u publikuar dhe herë pas here ndonjë vështrim krahasues i mbulimit të së njëjtës dukuri kulturore nga një gazetë dhe një tjetër.

Po t'i hedhim një sy peizazhit të shtypit të shkruar mund të thuhet se gjendja e shtypit letrar e kulturor në Shqipëri përjeton një farë zbatice, një rrudhje të ndjeshme. Më konkretisht, sot nuk ka një gazetë të mirëfilltë letrare-artistike. Gjithashtu në treg mungojnë revistat e përmuajshme. Në mënyrë krejt të çrregullt dalin revista e mendimit "Përpyekja", revista letrare "Aleph", revista letrare "Mehr Licht". Është zhdukur nga qarkullimi "Revista letrare" (ish-revista "Nëntori" e Lidhjes së Shkrimtarëve) dhe të njëjtin fat ka pësuar edhe gazeta "Drita" më e vjetra në vend. Nuk po përmendim këtu një numër të pafund organesh letrare të të rinjve, të cilat në qoftë se do të perifrazonim një shprehje të vjetër do të thonim se "lindin të vdekura". E vërteta është se një organ kulturor e letrar i mirëfilltë duke mos qenë në gjendje të konkurrojë në kushtet e tregut e ka të vështirë, për të mos thënë të pamundur, ekzistencën pa mbështetje financiare të institucioneve ose sponsorizuesve të ndryshëm.

2.

Metodologjia e punës së këtij monitorimi ka për të qenë këqyrja sipas topikëve ose tematikave të veçanta në mënyrë që qasja të jetë pikë së pari sa më konkrete, e detajuar dhe jo thjesht përgjithësuese.

a) Hapësira që i kushtohet Art & Kulturës.

Hapësira që i caktohet Artit & Kulturës, nën emrin përgjithësues Kulturë është pak a shumë e njëjtë të të gjitha gazetatat e përditshme të shtypit shqiptar. Më konkretisht bëhet fjalë për një hapësirë të përhershme prej dy-tre faqesh të përditshme, të cilat gjenden më së shumti pas rubrikës së Koment & Opioneve dhe para lajmeve nga bota ose lajmet sportive. Nga të pesë gazetatat e sipërpërmendura që janë përzgjedhur për këtë monitorim vetëm Gazeta Shqiptare ka një suplement Kulturor & Letrar, të titulluar Milosao, i cili ka 16 faqe dhe del një herë në javë, të djelën. Gazetat e tjera kanë hapësira speciale (në qoftë se mund të shprehemi kështu) të ashtuquajtura Faqet e së Shtunës, ose të Djelës, Week end, etj. Por të gjitha këto kanë më fort karakter zbavitës të tipit Gossip's, Leisure ose siç e quan gazeta Shqip separatin e vet Ndryshe, i cili është një amalgamë kërsërish dhe scoop'esh nga fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore, por shumë pak nga fusha e kulturës dhe e artit, madje edhe atëherë e ka të konceptuar si zbulim e fakt sensational. Krahasuar me shtypin e vendeve fqinje, këtu kam parasysh edhe atë të dy vendeve anëtare të BE-së, Itali e Greqi, hapësira që i lihet në dispozicion kulturës në median e shkruar shqiptare mund të themi se është pothuaj e njëjtë me të tyre. Por,

thënë figurativisht, siç do ta shohim edhe më poshtë, ndryshon Menuja që i serviret lexuesit. Për fat të keq vëmë re se, herë pas here, hapësira në dispozicion të kulturës shpesh herë rrudhet dhe në kurriz të saj përfitojnë reklamat, të ashtuquajtura rubrika speciale gjithfarësh, por edhe njoftimet të ndryshme me pagesë, si llotaria amerikane, lista e atyre që përfitojnë viza në ambasadat e huaja, lista studentësh etj.

Përsa i përket elementëve teknikë siç janë faqosja dhe design-i në përgjithësi është e vështirë të pikasësh ndryshime thelbësore nga njëra gazetë në tjetrën. Pozitiv është fakti që të gjitha gazetat kanë arkivat e tyre të fotografive si dhe fotografë, gjë që shmang ndjeshëm uniformitetin që mund të vihej re kohë më parë. E megjithatë edhe pse të bijen në sy fotografi të dimensioneve të ndryshme të cilat janë kurdoherë të pranishme, mungojnë elementë pikantë të cilët mund ta bënin më interesante faqen kulturore nga ana vizive, siç janë karikaturat ose ilustrime të ndryshme, si piktura, vizatime etj. Kësodore shpesh krijohet një farë uniformiteti që e bën monotone faqen dhe për rrjedhojë zbeh interesin e lexuesit. Nga ana konceptuale faqosja e Shqip-it ka një shije më moderne e bashkëkohore që të ndër mend një të përditshme italiane.

b) Ç'vend zënë shkrimet rreth librave dhe gjinive të tjera artit: kinematografi, arte pamore etj.

Me përjashtim të suplementit Milosao të Gazetës Shqiptare, i cili ka një rubrikë të përjavshme që i kushtohet librit, kryesisht librit të ri, nën okelion “Bibliotekë”, gazetat e tjera në faqet e tyre të përditshme nuk kanë kënde të posaçëm kushtuar librit ose fushave të tjera të krijimtarisë, gjë që ia lënë sporadicitetit të evenimenteve artistike, daljes në treg të librave të rinj, premiera të filmit ose teatrit, ekspozitës së aksh piktori etj.. Por, le t'i referohemi elokuencës së statistikave dhe të shohim se çfarë periodicitetin e secilës prej gazetave të përzgjedhura: Përgjatë muajit shtator gazeta Panorama nuk ka as edhe një shkrim për libër, film ose gjini të tjera të artit; gazeta Standard ka katër shkrime për libra, botime të reja (A. Çapaliku për “Fakticiteti në Letërs. Proza letrare e Anton Harapit” i Anton Goçajit, Bahri Myftari për vëllimin I të “Vepra dramatike e Fishtës”, Agim Zogaj për Lufta civile në Shqipëri” të Uran Butkës dhe Mark Simoni për romanin “Korbi” të Skënder Drinit.) Gazeta Shqiptare në faqet kulturore të këtij muaji ka vetëm një recensë për premierën e shfaqjes musical të Eva Alikajt “Lola Blum”. Gazeta Shekulli ka tri recensa ose shkrime librash: Elsa Demo për “Poezia Epike Gojore” të studiuesit Stavro Skëndi, romanin “Vejusha e dashuruar” të V. Muçit dhe për studimin e antropologes anngleze Clarisa de Vaal “Mbijetesa”. Gazeta Shqip më e reja në tregun mediatik shqiptar është më e pasura përse u takon shkrimeve të themi kritike për gjini të ndryshme të artit.

Brenda një muaji kjo gazetë ka dymbëdhjetë shkrime prej të cilave nëntë janë për librat e rinj (romanin “Dashuria zgjat tri vjet” të autorit frëng Frederick Beigebeider, për krijtarinë poetike të autorit pogradecar Dhimitër Pojanaku, shkrim për librin “Vajza që braktisa” të shkrimtarit japonez Shusaku Endo, shkrim për librin me studime të Enis Sulstarovës rreth figurës së Haxhi Qamilit, të dy këta shkrime nga Ermir Hoxha, dy recensa të gazetares Alda Bardhyli për “Hijet që enden” të shkrimtarit frëng Pascal Quignard dhe të zviceranit të mirënjohur Durremat “një ateist i pandreqshëm”, gazetari i faqeve kulturore të kësaj gazete rreth “Libri i zi i komunizmit shqiptar” të Agim Mustës, si dhe dy shkrime relativisht të gjatë, i pari nga Feride Papeleka për dy vëllimet rreth figurës së Fan Nolit të Nasho Jorgaqit dhe i dyti nga Ndue Dedaj për romanin e Flutura Açkajt “Kryqi i harresës”), ka gjithashtu një shkrim për një ekspozitë qeramike të hapur pranë Galerisë Kombëtare të Arteve (gjë e rrallë, për hir të së vërtetës, në faqet e shtypit kulturor) një recensë për filmin amerikan “Premoniton” të shfaqur në sallat e kinemasë (edhe kjo dukuri e rrallë ndonëse tejet e domosdoshme për t’i ardhur në ndihmë lexuesit dhe për ta orientuar) dhe një shkrim për dramën “Hanibali” nga kritiku i teatrit Josif Papagjoni që ka lëvruar kritikën e këtij zhanri, por që shkruan me porosi dhe me hope. Duhet shtuar edhe një fakt: Shqip ka edhe një rubrikë informacioni rreth librave të rinj të quajtur “Vitrinë” ku pasqyrohen rregullisht titujt e botuar së fundmi. Këtë rubrikë nuk para e hasim në gazetat e tjera, pa zënë ngoje këtu suplementin “Milosao”. Ajo që mungon rregullisht te të gjithë organet kulturore është matja e pulsit të tregut për shitjet e librave dhe lista e të ashquajturave bestseller, një praktikë që haset rëndom në faqet kulturore të të përditshmeve serioze europiane e më gjerë.

Në qoftë se do t’u referohemi sërish statistikave të botimit të librave, mbi njëqind tituj në muaj, do të vemë re se vetëm një pjesë e vogël e tyre arrin të gjejë një hapësirë në faqet e shtypit kulturor të gazetave të përditshme. Sigurisht që jo të gjitha prurjet e tregut mund të pasqyrohen në shtyp, por autorët më të rëndësishëm dhe veçmasi të rinjtë që kanë nevojë të promovohen dhe për të cilët shtypi është një mekanizëm i domosdoshëm dhe i pazëvendësueshëm. Po kështu në qoftë se do t’u referoheshim statistikave të sipërpërmenduar, vërejmë se nga shtatëmbëdhjetë shkrime për librat e rinj, njëmbëdhjetë u përkasin autorëve shqiptarë dhe vetëm gjashtë autorëve të huaj. Ma do mendja që është pozitiv fakti i verifikuar edhe më parë se nuk ka diferencime në kurriz të autorëve shqiptarë në favor të atyre të huaj, përkundrazi. Por, nga ana tjetër, lypset theksuar se kemi të bëjmë më fort me vështrime përshkruese dhe lavdëruese sesa me kritika të mirëfillta dhe recensa për librin. Por gjithsesi problemi me i mprehtë nuk është ai i sasisë sesa i cilësisë. Shpesh gazetarët nuk përbëjnë filtër për librat e dobët, por i

pasyrojnë dhe madje, shpesh u kushtojnë të njëjtën hapësirë ashtu si edhe librat e mirë, gjë që çorodit lexuesit dhe kompromenton besueshmërinë e gazetës.

Me ndonjë përjashtim të rrallë, siç edhe mund të vihet re nga shembujt e mësipërm, mungojnë pothuajse tërësisht shkrimet kritike për teatrin, filmin, ekspozitat e arteve pamore, pikturë, fotografi etj. Një e dhënë tjetër që ngjall interes ka të bëjë me faktin se shkrimet përgatiten në pjesën më të madhe të rasteve nga vetë gazetarët e kulturës, të cilët nuk kanë përgatitjen specifike që kërkon kritika letrare ose ajo e filmit, teatrit, artit pamor e kështu me radhë. Në rastet e shkrimeve për librat e rinj, të përmendur pak më sipër, vetëm pesë artikuj u përkasin bashkëpunëtorëve të jashtëm të gazetës, shkrimet e tjerë mbajnë firmën e gazetarëve. Është e lehtë të konstatohet që gazetatat nuk kanë bashkëpunëtorë fiks për rubrika të caktuara të faqeve kulturore ose artistike, gjë që konsiderohet praktikë e rëndomtë dhe gjen zbatim gjerësisht madje edhe në rajon.

c) Burimet që shfrytëzohen.

Nga një vështrim i shpejtë që mund t'u hedhësh shkrimeve që rrokin tematika dhe problematika të kulturës ke për të hasur në atë që mund të quhet një nga "thembrat e Akilit" të gazetarisë së shkruar. Në këtë kuptim, gazetaria kulturore nuk dallon nga simotrat e saj politike, ekonomike, të aktualitetit e kështu me radhë, përse i takon cenit të mos identifikimit të burimit të shkrimeve. Shpesh ndodh që komunikata të hedhura në postën elektronike të gazetës ose të gazetarit të kulturës nga institucione kulturore, shoqata ose organizata të ndryshme botohen të plota dhe të paverifikuara, gjë që, me të drejtë lë vend për dyshime dhe ngandonjëherë mund të shkaktojë reagime për njëanshmëri nga subjekte të ndryshëm. Jo rrallë mund të qëllojë që shkrimi ose komunikata e aksh individi ose shoqate të botohet njëkohësisht në dy-tri gazeta, ngaqë gazetari ose gazetarja e gjen me të lehtë të bëjë *short cut* e ta botojë shkrimin ashtu siç i serviret sesa të marrë mundimin e të verifikojë për të mos thënë të hulumtojë rreth tij e të ndërtojë një shkrim ku të citojë individin dhe/ose shoqatën për problemin në fjalë, por, nga ana tjetër, të citojë edhe krahun tjetër.

Sigurisht gazetarët e kulturës shpesh hasin në pengesa e vështirësi kur kërkojnë prononcime sidomos nga strukturat dhe institucionet e shtetit, por kjo nuk përligj plogështinë për të gjetur rrugën më të lehtë e për t'i ofruar lexuesit ushqim të njëanshëm dhe shpesh të pasaktë, ashtu siç përcillet nga zyrat e shtypit ose zëdhënësit përkatës.

d) Vendi që zënë intervistat, çështjet që ngrihen në to dhe mënyra se si ndërtohen pyetjet.

Intervista ngjan të jetë zhanri më i parapëlqyer nga gazetarët e kulturës. Nuk është aspak e vështirë për të arritur në këtë përfundim kur vë re që intervista zë vendin kryesor në faqet kulturore të gazetave. Për të qenë më konkretë: Në harkun e një muaji, pra, shtatorit, gazeta Shqip ka 6 intervista; Shekulli 6; Standard 4; Gazeta Shqiptare, pa Milosaon, 2; dhe Panorama 6 intervista. Nga ana tjetër tek intervista vihet re edhe një larmi më e madhe krahasuar me zhanre të tjera. Fjala vjen të intervistuarit janë këngëtarë (më së shumti), aktorë, shkrimtarë, regjisorë, kuratorë ekspozitash, por nuk mungojnë edhe burokratë të kulturës. Këtu shfaqet një tjetër mangësi, ose pamundësi, quajeni si të dëshironi, e gazetarëve të kulturës; në mbi nëntëdhjetë përqind të rasteve intervistat janë me personazhe lokalë dhe vetëm në raste shumë të rralla mund të hasësh në *celebrities* të njohur në botë. Kësisoj përbën ngjarje intervista me Xhim Belushin botuar në Panorama të datës 2 shtator. Me këtë rast nuk dëshiroj të përmend këtu intervistat e përkthyer nga faqet e shtypit të huaj, më së shumti atij italian, dhe që nuk respektojnë të drejtat e mbrojtura me ligj të autorit, në rastin në fjalë të gazetës përkatëse prej kah është nxjerrë intervista ose shkrimi. E megjithatë mund të thuhet se sot kemi të bëjmë me një dukuri e cila, krahasuar me atë çka ndodhte në shtyp në fillim të viteve nëntëdhjetë, ka ardhur duke u rrudhur dhe u minimizuar në mënyrë të ndjeshme. Shfaqjet e rralla që vihen re janë gjithsesi një anakronizëm nga ana profesionale, i cili, nuk mund të thuash që përbën një dukuri tipike. Elsa Demo e Shekulli-t dhe Alda Bardhyli e Shqip-it shpalosen si gazetaret më ambicioze në përpjekjet që bëjnë për të kontaktuar e për t'i ofruar lexuesit të gazetave të tyre shkrime ekskluzive me shkrimtarë, regjisorë ose personalitete të ndryshëm të artit e kulturës europiane. Sidoqoftë janë përpjekje të ishulluara dhe nuk janë pjesë e zakonit e menuesë kulturore.

Ajo çka bije në sy si defekt i intervistave dhe në këtë pikë e kemi fjalën, s'do mend, për intervistuesin është fakti që ngandonjëherë personazhi publik që zgjidhet për t'u intervistuar nuk lidhet me ndonjë ngjarje artistike të ditës, marrje çmimi, realizim premiere ose botim libri të suksesshëm, por të krijon përshtypjen e të pikasurit në mënyrë kuturu, shpejt e shpejt, e me ngut, si e si për të realizuar normën, pra, për të mbushur faqen. Prej këndeje ka të ngjarë të rrjedhë edhe një defekt tjetër i intervistuesit/ses, të gjendurit i papërgatitur në çastin e realizimit të intervistës, çka do të thotë që nuk ka parë shfaqjen, ose nuk ka lexuar librin, ndaj dhe pyetjet e tij/saj janë të përgjithshme, përcipta e monotone, kallëpe që me një modifikim të vogël mund të përdoren kudo e me këdo.

Shpesh pyetjeve u mungon sensi kritik dhe janë thjesht ilustruese të idesë së shprehur nga autori i veprës, çfarëdoqoftë ajo. Kësisoj gazetari/rja ngurron ngaqë nuk ka guximin e duhur të bëjë edhe të ashtuquajtura pyetje delikate, të mprehta, me spec, çka kishte për të qenë normale dhe krejt profesionale në qoftë se ka bindjen se ajo që po bën është e drejtë dhe e ndershme, sidomos kur e ndjen se nuk ka synime të mbrapshta për ta fyer ose provokuar të intervistuarin.

Le të hapim një parantezë në këtë pikë dhe për t'i ilustruar një pjesë të vërejtjeve të mësipërme t'i hedhim një sy intervistës që gazetarja e Panoramës bën me ministrin e Kulturës z. Ylli Pango, rreth veprimtarisë 10 ditore të ndërmarrë nga qeveria shqiptare me rastin e 10-vjetorit të vdekjes së Nënë Terezës. Le ta themi qysh në krye që çdo gazetar ka të drejtën e vet ta ndërtojë një intervistë si t'i vijë për mbarë, ndaj nuk kam ndër mend ta paragjykoj atë, veç të shpreh disa mendime se si mund të kishte vepruar një gazetar hipotetik në të njëjtin rast. Por le t'i referohemi intervistës. Fjala vjen, kur Ministri deklaroi se janë shpenzuar 28 milionë lekë të reja, pra, afërsisht 280.000 dollarë amerikanë, për një veprimtari ku bijen më shumë në sy zyrtarët e lartë të qeverisë dhe të shtetit gjithë pohë e bujë sesa shenjtorja e të varfërve dhe të gërbulosurve të botës, çdo gazetar me të drejtë mund ta pyeste “Mos vallë kjo gjë bie ndesh me frymën dhe besimin të cilit i kushtoi tërë jetën Nënë Tereza?” Si ka mundësi që kurrkush nuk u kujtua për motrat e Urdhrit të saj dhe t'i pyeste se çfarë mendonin e sugjeronin për këtë veprimtari? Më tej, Si mundet një gazetar të shkojë e të pyesë një zyrtar se çfarë i dhurove Nënë Terezës dhe çfarë të dhuroi ajo, kur dihet që ajo nuk pranonte dhurata materiale nga zyrtarë e qeveritarë, por vetëm nga organizma ndërkombëtarë dhe shoqata bamirësie? Si ka mundësi që një gazetare që punon çdo ditë në terren dhe e njeh dita me ditë realitetin ku jeton e punon, nuk e pyet Ministrin se sa mishëron Shqipëria e sotme dhe burrat e gratë e shtetit shqiptar idealet e Nënë Terezës? Dhe për ta mbyllur këtë vështrim kritik mbi këtë intervistë në kokë të intervistës, gazetarja shkon e vë për të “intriguar” lexuesin shprehjen sedërpërkëdhelëse për Ministrin “Takimi im një orë me Nënë Terezën”, a thua se bëhet fjalë për ndonjë *rendez vous* të Ministrit me një star të Hollywood-it. Kërkoj ndjesë për cinizmin, por kjo është ndjesia që kjo intervistë të përcjell si lexues.

Gjithsesi ky është një “mëkat” që ku më shumë e ku më pak e hasim edhe te kolegët e shtypit politik. Shpresojmë që ky konstatim të shërbejë për t'i ngushëlluar sadopak gazetarët e kulturës.

e) Përzgjedhja e ngjarjeve kulturore, dukurive dhe problematikave të ndryshme për t'u mbuluar.

Përgjithësisht gazetarët e kulturës pasqyrojnë çdo ngjarje kulturore që zhvillohet në kryeqytet. Rrallë pasqyrohen ngjarjet kulturore të qyteteve të provincës dhe vetëm në ato raste kur kemi të bëjmë me veprimtari të karakterit kombëtar ose ndërkombëtar. Ajo që mungon krejtësisht janë mbulimi i eventimeve kulturore europiane; fjala vjen festivalet e filmit, konferencat kulturore, panairët e librave, festivalet teatrore etj., të cilat pasqyrohen gjerësisht në faqet e të gjitha të përditshmeve europiane. Por kam përshtypjen që këtu kemi të bëjmë me fort faktorë jashtë profesionalë e kulturorë; thënë më shkoqur, mungesë fondesh për t'i mbuluar këto veprimtari.

Të bije në sy se në të gjitha gazetatat e përditshme, të mëdha ose të vogla, pasqyrohet rregullisht kronika e veprimtarive kulturore. Pra, kemi të bëjmë me një mbulim më së shumti horizontal dhe jo vertikal të këtyre veprimtarive. Çka do të thotë se materialet në pjesën dërrmuese të rasteve kanë karakter deskriptiv dhe rrallëherë karakter analitik e kritik. Pjesë e kronikës së mësipërme janë edhe ngjarjet e mëdha kulturore europiane ose botërore. Burim i informacionit ose i lajmit janë agjencitë, shtypi i huaj dhe kryesisht vjeljet nga interneti që përbëjnë edhe burimin më të rëndësishëm e që shfrytëzohet më së shumti.

Të pakta janë shkrimet problematike dhe ato që marrin e trajtojnë dukuri të jetës kulturore e artistike. Përveç vështirësive që hasin gazetarët e rinj në trajtimin e tyre, një tjetër pengesë është edhe hapësira e rrudhur e faqeve të kulturës, çështje që e kemi trajtuar edhe më lart.

f) Vështrim krahasues rreth mbulimit të ngjarjeve dhe dukurive kulturore nga një gazetë në tjetrën.

Përgjithësisht faqet kulturore vuajnë nga një farë monotonie në pasqyrimin e kalendarit kulturor në vend. Çështja nuk është se atë lajm që has në një gazetë e has gjithandej, te të gjitha simotrat e saj, por te fakti se lajmi riprodhohet pothuajse brenda së njëjtës skemë, a thua se është ushqim gjysmë i gatshëm që blihet i konfeksionuar në të njëjtin supermarket. Gjendja ndryshon disi kur vjen puna te dukuritë kulturore ose ngjarjet me një farë peshe në jetën kulturore e shoqërore të vendit.

Për të hedhur një vështrim komparativ rreth mbulimit të së njëjtës ngjarje kulturore në faqet kulturore të pesë gazetave të përzgjedhura kemi marrë vdekjen e franceskanit të

nderuar, por sidomos njeriut të kulturës dhe të letrave shqipe At Zef Pllumi, të dekoruar nga Presidenti i Republikës me titullin “Nderi i Kombit” dhe në vitin 2006 me çmimin “Penda e Artë” për veprën e tij letrare të shumëvëllimshme. Pra, në aspektin ontologjik kemi të bëjmë me personazhin e fundit të rëndësishëm të një brezi klerikësh që kontribuan dhe ndikuan në letrat dhe kulturën shqipe.

E përditshmja Shekulli e datës 26 shtator, hapet me fotografinë e klerikut dhe me një njoftim për vdekjen e tij, duke e cilësuar “Të fundmin e rezistencës antikomuniste (!) për të vazhduar në fq. 15 me një shkrim ku përmbledhtazi jepet jetëshkrimi i tij i shoqëruar me disa fotografi. Të tërheq vëmendjen fakti se në faqen paraardhëse redaksia ka vendosur foton e madhe të një të riu jezuit si dhe një shkrim rreth ringjalljes së misionit të jezuitëve në Shqipëri. Një ditë më pas, më datë 27 shtator, po kjo gazetë hapet sërish me një foto të klerikut dhe hyrjen e shkrimit të Kadaresë me titull “Udhë të mbarë në botën që s’ka fund”. Në brendësi gazeta pasqyron mesazhet e ngushëllimit të Presidentit rishtar të Republikës, Kryeministrit Berisha e me radhë Kadare, Ndreca, Bardhyl Londo, Shamku-Shkreli dhe një intervistë e ribotuar e E. Demos, tok me njoftimin për ceremoninë e përmortshme që do të mbahet në Shkodër. Më datë 28, gazeta boton një shkrim të përkthyeses në gjuhën angleze të librit të Zef Pllumit “Rrno për me tregue”, Kathleen Schank, tok me kronikën përkatëse të veprimtarive që priten të zhvillohen me mbërritjen e trupit në Shqipëri dhe të ceremonisë së përmortshme. Bijen në sy citimet nga prononcimet e krerëve të maxhorancës, por jo të krahut tjetër. Më datë 29, po në faqe të parë, gazeta jep njoftimin e mbërritjes së trupit të të ndjerit nga Roma në Shkodër dhe vijon në brendësi me kronikën e rastit. Një vend të konsiderueshëm, ashtu si edhe në shkrimet e mëparshme, zënë fotot e të ndjerit. Më datë 30 shtator, dita meshës dhe e përcjelljes së të ndjerit për në Shtëpinë e të Atit, Shekulli befas e ndërpret sagën, pa dhënë kurrfarë lajmi, qoftë edhe të thatë, për t’i dhënë hapësirë vdekjes së aktorit të mirënjohur shkodran Serafin Fanko, në njërën faqe dhe, në tjetrën, lajmit se tetori ka për të qenë muaji gjerman i kulturës dhe veprimtarive që kanë për t’u kryer në të.

Gazeta Panorama e datës 26 shtator jep lajmin e vdekjes së At Zef Pllumit në të shoqëruar me fotografi në faqe të parë dhe në brendësi, fq. 4, të dhëna rreth jetës dhe veprës së klerikut. Të bie në sy se ndryshe nga gazeta e cituar më sipër, Panorama ka një regjistër gjuhësor të thjeshtë, pa tone emfaze dhe patetizmi emocional. Më datë 27, Panorama boton një opinion të Mark Markut me titullin kuptimplotë “At Zef Pllumi, i fundmi i etërve të mëdhenj”. Por kjo gazetë nuk ndalet këtu, në hapësirën kulturore, f. 21, ndërton hollësisht portretin e klerikut, viktimës së diktaturës dhe njeriut të letrave të shoqëruar me foto të ndryshme të të ndjerit. Më datë 28, gazeta riprodhon vendimet e

marra prej qeverisë me këtë rast dhe konsiderata të përfaqësuesve të politikës, janë po ata që janë shfaqur edhe në organe të tjera të shtypit të shkruar dhe atij elektronik, si dhe sjell një risi: mbresa prej dy fretënve të tjerë franceskanë: At Ambroz Martini dhe At Zef Simoni, gjë që, nuk kemi për ta hasur në organe të tjera. Në numrin e datës 29 shtator, gazeta riprodhon me skrupulozitet kronikën e mbërritjes së trupit të Zef Pllumit në Rinas dhe ceremonialin e pritjes së organizuar me këtë rast. Në datën 30, ashtu si edhe e sipërpërmendura Shekulli, Panorama nuk jep qoftë edhe me një rresht ceremoninë e përmortshme të kryer në Shkodër, por brenda së njëjtës skemë të përdorur edhe nga Shekulli sjell lajmin e “shuarjes” së Aktorit të Popullit, Serafin Fanko.

Ndryshe nga dy gazetatat e përmendura më sipër, Gazeta Shqiptare e datës 26 nuk ka kurrfarë lajmi për vdekjen e At Zef Pllumit. Ndërsa një ditë më pas, kjo gazetë ia kushton dy faqet e kulturës të ndjerit me jetëshkrime, intervista dhe prononcime personazhesh të ndryshëm nga politika dhe letrat shqipe. Të tërheq vëmendjen fakti se fotot e riprodhuara prej kësaj gazete janë të ndryshme prej atyre që kemi shfletuar deri më tash. Më datë 28 Gazeta, përmes korrespondentes në Shkodër, Brikena Shllaku, përcjell kalendarin e përgatitjeve për lamtumirën e fundit që do të kryhen në këtë qytet, si dhe kujtime të vëllezërve të petkut të Shën Franceskut për Zef Pllumin në kuadër të një reportazhi nga Kuvendi franceskan i Shkodrës. Më datë 29 shtator, Gazeta mjaftohet me një foto-lajm në f. 26, të kulturës, për t'i dhënë lexuesit lajmin e mbërritjes në Shqipëri të trupit të të ndjerit. Gazeta Shqiptare e së djelës, datë 30 shtator, nuk i kushton ndonjë resht ceremonisë së përmortshme, por në suplementin e vet “Milosao” boton një recensë të gazetares dhe kritikes letrare Arta Marku për librin e Zef Pllumit “Rrno për me tregue”. Një javë më pas, po në faqet e “Milosaos”, përmes pendës së redaktorese përgjegjëse Admirina Peçi, përcillet një shkrim i gjatë lidhur me marrëdhëniet e koklavitura dhe shpesh konfliktuale të klerikut me superiorët e tij në Vatikan.

Gazeta Shqip e datës 26 shtator nuk përcjell ndonjë lajm për vdekjen e klerikut të shquar. Në faqen e parë të datës 27, Shqip përcjell lajmin e shuarjes në Romë të atij që Rrnoi për me tregue dhe në brendësi, në faqet 28-29 riprodhon në një foto gjigante portretin e klerikut dhe përkrah citateve të nxjerra nga deklaratat e Berishës dhe të Topit boton edhe një shkrim të gazetares së kulturës për jetën dhe veprën e At Zef Pllumit. Shqip i datës 28 mjaftohet me kronikën e një minutë heshtjeje të mbajtur nga Kuvendi i Shqipërisë për nder të figurës së të ndjerit. Ndërsa më datë 29, gazeta jep thjesht e shkurt kronikën e mbërritjes së trupit në Shqipëri, teksa në dy faqe kushtuar klerikut jezuit italian Giacomo Gardini, të dënuar nga diktatura, gjen vend e fut edhe një foto me didaskali të franceskanit Zef Pllumi të dekoruar me medaljen Nderi i Kombit. Gazeta Shqip e datës 30

teksa vazhdon serialin e kujtimeve të jezuitit Gardini, këtë herë nuk gjen vend për të dhënë kronikën e varrimit të franceskanit Zef Pllumi.

Gazeta Standard e datës 26 shtator nuk ka asnjë lajm për vdekjen e At Zef Pllumit më 25 shtator në klinikën “Gemelli” në Romë. Më datë 27 vihet në lëvizje mekanizmi gazetaresk dhe kjo gazetë ashtu si simotrat e saj më së shumti shkon e i kushton dy faqet e kulturës figurës së klerikut. Përveç jetëshkrimit të kudogjendshëm të gazetares së faqes kulturore me titullin pak bizarre “Të jesh mirë, Patër Zef!” kjo gazetë riprodhon një intervistë të hershme të franceskanit, ku sjell në vëmendje të lexuesit vitet e para të lirisë fetare dhe politike në Shqipërinë e pas viteve nëntëdhjetë, kur ai sapo ishte liruar nga burgu. Më datë 28 kjo gazetë nuk i kushton as edhe një rresht të vetëm në faqet e kulturës vdekjes së humanistit të fundit të letrave dhe kulturës shqipe, por në faqet e brendshme të politikës përmend faktin se zj. Topalli i kërkon Kuvendit të mbajë një minutë heshtje në nderim të tij. Të shtunën, më datë 29, Standard i kushton faqen e parë me një foto të madhe dhe në *headline* lexojmë, “At Zef Pllumi, Saga e papërfunduar”. Si për të mbushur zbrazëtirën e lënë një ditë më parë, kjo gazetë i kushton editorialin e faqes 3, me titullin bombastik “Martiri i fundit”, ndërsa në brendësi i kushton ngjarjes katër faqe të kulturës, dy gazetarja e kësaj faqeje në një shkrim që përmban edhe kronikën, historinë e shumëçka që lidhet me figurën e të ndjerit, por edhe diçka për veprimtarinë kulturore të franceskanëve. Dy faqet e tjera i janë lënë një shkrimi të ribotuar të Zef Pllumit, me titull “Demokracia shqiptare me dy diktatorë”. Ndërsa varrimit të klerikut të shquar më datë 30, kjo gazetë ashtu si edhe ato paraardhëse nuk i kushton hapësirë as si lajm, as si kronikë.

Jo pa qëllim ndërtoam një kuadër të plotë e të detajuar të një ngjarjeje, siç ishte ajo e vdekjes së klerikut atdhetar dhe njeriut të shquar të letrave, At Zef Pllumit, e cila për dy-tre ditë radhazi ngërtheu vëmendjen e gazetarëve të kulturës dhe pushtoi më së shumti plotësisht hapësirat e faqeve kulturore, por shpesh u shfaq e u anunçua edhe në faqe të parë, ndër lajmet kryesore të ditës. Me përjashtim të një farë uniformiteti në dhënien e lajmit dhe ndjekjen e dinamikës së zhvillimit të ngjarjes dhe përsëritjeve në mënyrat e vlerësimit dhe trajtimit të figurës, gjë që, deri-diku ngjan e pashmangshme, duhet të themi se mbulimi i evenimentit ishte korrekt, madje do të përfizonte vëmendjen maksimale, çka edhe i shkon karizmës së figurës së pazakontë të klerikut, pasardhësit më të fundit nga ai brez franceskanësh që dhanë një ndihmesë të pazakontë në letrat dhe kulturën shqipe. E vetmja mangësi e ndjeshme, çka vihet re në të pesë gazetatat e monitoruara, është rindërtimi i pjesshëm i portretit të figurës së Zef Pllumit, duke u përqëndruar më fort në ekzotikën e së shkuarës, petku, të qenit pasardhës i Fishtës, burgu gjatë diktaturës e kështu me radhë, por duke lënë të paplotësuar atë pjesë të veprimtarisë së tij që lidhet

me periudhën pas viteve '90. Dhe këtu nuk e kam fjalën për veprimtarinë e tij kishtare, por kulturore, ku spikat fakti që plaku i nderuar do të ishte për një farë kohe kryetar i Bordit të Këshilltarëve të ministrit të Kulturës së asaj kohe, Edi Rama etj. Pra, gazetarët pak kanë shfrytëzuar arkivat dhe skedat e shtypit, por janë mbështetur kryesisht në informacione dhe materiale që gjendeshin rreth e qark e tyre dhe nuk kërkonin mund kërkimi.

g) Në ç'raport janë lajmet kulturore të huaja me ato të vendit.

Paradoksalisht kemi të bëjmë me një dukuri që fillimisht shënonte një udhë të mbarë dhe ecje përpara në gazetarinë kulturore, ndërkohë që sot rrezikon të kthehet në të kundërtën e vet, pra në një dukur retrograde. E kam fjalën jo për raportet e zhdrejta përsa i përket nga ana sasiore lajmeve të vendit mbi ato të huaja (deri këtu nuk ka asgjë të keqe), por në atë çekuilibër që vihet re në cilësinë e lajmit dhe për rrjedhojë të materialit që pasqyrohet. Le të kryejmë një shmangie të lehtë nga korniza kohore që kemi përzgjedhur më sipër, pra, shtatori, dhe le t'i hedhim një sy e të shohim konkretisht se si është mbuluar java e dhënies së çmimeve Nobel këto ditë, ngjarje që për gazetarët e kulturës, s'do mend, mbërrin kulmin me Nobelin për letërsinë. Mos harrojmë që kemi të bëjmë me ngjarjen më të madhe kulturore globale, e cila gjen pasqyrim gjerë e gjatë e të hollësishëm në të gjithë shtypin botëror, madje jo vetëm atë qendror, por edhe periferik. Në faqet e shtypit tonë të shkruar çmimi Nobel për ekonominë, mjekësinë, Paqen etj., konsiderohet lajm i thatë, thjesht kronikë, ndërsa diçka më shumë vëmendje i kushtohet Nobelit për letërsinë, por jo aq sa duhet, veçmasi kur kemi të bëjmë me shkrimtarë ose shkrimtare të panjohur për lexuesin dhe/ose botuesit shqiptarë. Ndërkohë që shkrimet, analizat (madje edhe me theks kritik), intervistat etj., mungojnë tërësisht.

Pra, rreziku është që lokalizimi i skajshëm i kulturës mund të na shpjerë, pashmangshmërisht, në provincializimin e saj. Globalizimi, edhe ai kulturor, është një dukuri konkrete, e prekshme, madje do të thosha një proces që ka nisur me kohë dhe po zhvillohet me ritme marramendëse. Gazetarët dhe kultura shqiptare nuk mund të rrinë e bëjnë sehir nga ballkoni i apatisë dhe i provincializimit.

3. Përfundime

Vërejtje e sugjerime.

- Një mungesë të ndjeshme dhe të pakonceptueshme sot e kësaj dite përbëjnë editorialët e kulturës. Kësisoj do t'u jepej hapësirë trajtimit të problematikave të kulturës shqipe, si brenda vendit ashtu edhe në raport me botën. Për fat të keq vërejmë se shpesh shkrime problemore për çështje të artit e kulturës kalojnë si opinione të politikës në faqen e parë.
- Tashmë përbën një zbrazëti të papërfytyrueshme mungesa e kritikës së specializuar për gjini të ndryshme të artit. Më së shumti kjo gjë ndjehet për filmin, teatrin, artet pamore etj., ndërkohë që libri gjen një pasqyrim më të mirë, ndonëse jo ende në nivelin e një kritike të specializuar.
- Ngandonjëherë gazetaria kulturore endet në segmentin midis një lokalizmi provincial dhe kozmopolitizmi absurd.
- Gjykojmë se do të ishte më e volitshme për vetë gazetarët, por edhe për lexuesin ndarja e rubrikave të kulturës nga Arti dhe Spektakli.
- Unifikimi i ngjarjes (evenimentit) kulturor me kronikën kulturore.
- Kultura si scoop i politikës; përgojimi dhe përdhosja e personaliteteve të artit e të kulturës nga personazhe periferikë që orvaten të fitojnë vizibilitet në kurriz të tyre. Rasti i Kadaresë dhe tash së fundi "dueli" në distancë Kadare-Trebeshina mes të tjerëve.
- Mbajtja krahas dhe rreshtimi partizan i gazetarit në polemikat e natyrshme mes njerëzve të artit. Në rast kemi të bëjmë me një sëmundje të politikës të mbartur në kulturë. Rastet e polemikave Kadare, Qosja, Trebeshina, Çuli.
- Jo rrallë vihet re një gjuhë e varfër e gazetarëve të kulturës në shkrimet e tyre dhe, ç'është më e keqja, sintaksë e përçudur dhe gabime të shumta drejtshkrimore. Në këtë aspekt mendoj që faqet e kulturës dhe materialet që përfshihen në të duhet të shërbejnë si model edhe për rubrikat e tjera të gazetës.
- Edhe pse kjo mund të konsiderohet një lëngatë që i takon të shkuarës, prapëseprapë ndodh që gazetaria kulturore vlerësohet si punë të dorës së dytë dhe si trampolin për të kaluar në sektorë më dinjitozë dhe të fisëm si politika etj.
- Edhe gazetaria e kulturës, ashtu si edhe një pjesë e mirë e gazetarisë së shkuar vuan nga pirateria dhe mos respektimi i të drejtave të autorit kur bëhet fjalë, sidomos, për lajme, shkrime eseistike, portrete ose fragmente librash të shkrimtarëve ose krijuesve të huaj në përgjithësi.

Rekomandime.

- Organizimi i seminareve dhe kurseve të trainimit ku të ftohen, veç lektorëve, edhe shkrimtarë, kulturologë, e artistë gjithfarësh për të diskutuar e rrahur mendime me gazetarët/ret sidomos me ata/ato që janë rishtarë.
- Shkëmbim përvojash me gazetarë të huaj dhe kolegë sidomos nga vendet fqinje, çka do të ndihmonte në njohjen e ndërsjelltë të produkteve artistike e kulturore bashkëkohore dhe të politikave e problematikave në këtë fushë.
- Krijimi i një network-u kulturor mes gazetarëve të rajonit të Ballkanit për të ndihmuar në shkëmbimit e informacionit mes tyre dhe lehtësimin e punës së shoku-shokut. Fjala vjen, kësisoj, përveç huazimeve të shkrimeve të njëri-tjetrit, gazetarët e kulturës mund edhe t'i vijnë në ndihmë njëri-tjetrit për t'u lidhur me shkrimtarë, kineastë dhe artistë gjithfarësh për t'i intervistuar e shkruar rreth tyre.
- Krijimi i një çmimi vjetor për gazetarët e kulturës si stimul për punën dhe kontributin e tyre në këtë fushë. Këtë çmim mund ta japin Shoqata e Botuesve për *book review* më të mirë për vitin, mund ta japë Instituti i Medias ose cilido institut tjetër që lëvtron projekte në këtë fushë për gazetarin/en më të mirë të vitit, por kurrësi Ministria e Kulturës ose institucione në vartësi të saj (siç është folur shpesh), çka do të komprometonte panashmërinë dhe besueshmërinë profesionale të gazetarit e të gazetës.
- Hartimi i një kodi të etikës kulturore, diçka e ngjashme me dhjetë komandamentet (urdhëresat) e gazetarit që rendit Adam Michniku, si masë e peshë gjykimi dhe vlerësimi moral për gazetarët/ret, veçanërisht ata të rinj.